



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 3, datë 01. 03. 2012

PËR

“ZMADHIMIN E KAPITALIT TË “KLUBIT TË FUTBOLLIT TIRANA SHA”

Në mbështetje të nenit 8/1/II”a” dhe “c”, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 135, 168 dhe 169 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nenit 26, 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar); Statutit të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Tirana” sha; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 14, datë 12.10.2011 për “Transformimin në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit “Tirana”, miratimit të aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë aksionare të Klubit të futbollit “Tirana”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 25, datë 28.12.2011 për “Miratimin e buxhetit të vitit 2012”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Zmadhimin e kapitalit të “Klubit të Futbollit Tirana” sha me vlerën prej 80.000.000 (tetëdhjetë million) lekë duke nënshkruar 80,000 (tetëdhjetë mijë) aksione të reja, me vlerë nominale prej 1000 (një mijë) lekë.
2. Kapitali i “Klubit të Futbollit Tirana” sha pas zmadhimit do të shkojë nga 6.445.263.000 (gjashtë miliard e katërqind e dyzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë që ishte më parë , në 6.525.263.000 (gjashtë miliard e pesëqind e njëzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, të ndara në 6.525.263 (gjashtë milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) aksione.
3. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari Bashkia e Tiranës, brenda datës 31.12.2012.
4. Ngarkohet administratori i shoqërisë të ndjekë procedurat ligjore për regjistrimin e vendimit për zmadhimin e kapitalit dhe depozitimin e dokumentacionit përkatës pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.
5. Ngarkohen “Klubi i Futbollit Tirana” sha, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI